



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 21 shtator 2012
Nr. ref.: RK307/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI55/12

Parashtruesi

Avni Shabani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr.
132/2009, të 17 janarit 2012**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga Z. Avni Shabani (në tekstin e mëtejshëm: Parashtruesi), i përfaqësuar nga Z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012, që i është dorëzuar atij më 12 mars 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), respektivisht neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 22 maj 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin nr. GJR.KI-55/12, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin nr. Kolegji Shqyrtues. KI-55/12, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 25 korrik, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
8. Më 21 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares Raportues dhe i paraqiti rekomandimin Gjykatës për papranueshmërinë e Kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Në vitin 2007, i biri i parashtruesit ishte mbytur në një aksident me veturë. Rrjedhimisht, parashtruesi ushtroi padi kundër kompanisë së sigurimit për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale në Gjykatën Komunale në Lipjan.
10. Më 17 shtator 2007, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktgjykimi C. nr. 119.07) aprovoi padinë e parashtruesit për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale. Kompania e sigurimit ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër këtij Aktgjykimi.
11. Më 11 mars 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (aktgjykimi Ac. nr. 897.2007) pjesërisht hodhi poshtë ankesën e kompanisë së sigurimit si të pabazuar dhe mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Në lidhje me normën e interesit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi ankesën e kompanisë së sigurimit dhe ndërroi shumën e normës së interesit. Kompania e sigurimit ushtroi një revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut.
12. Më 17 janar 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 132/2009) pjesërisht aprovoi kërkesën për revizion dhe ndryshoi aktgjykimin e gjykatave më të ulëta sa i përket shumës së kompensimit të dëmeve materiale dhe jo-materiale. Gjykata Supreme

konstatoi se gjykatat e ulëta në lidhje me shumën e caktuar për kompensim të dëmeve materiale dhe jo-materiale ishte shumë e lartë dhe nuk ishte në pajtim me nenin 200 paragrafi 2 në lidhje me nenin 201 të Ligjit për Detyrimet.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme u mor në kundërshtim me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse ka “[...] raste të shumta kur Gjykata Supreme me kërkesën e palëve të dëmtuara rritë këto shuma, ndërsa nuk kemi raste që i ka zvogëluar dhe ky rast është i pari që ka gjykuar Gjykata Supreme e Kosovës kësajsoj. Me këtë Aktgjykim, paditësit i ka vënë në pozitë të pabarabartë me paditësit e tjerë[...].”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata vëren se për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për papranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1c) të Rregullores së Punës që përcakton se “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”.
16. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabime në fakte ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për sa kohë të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara më Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
17. Në përgjithësi, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
18. Për më tepër, parashtruesi vetëm konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në tërësi ligjin e zbatueshëm dhe nuk pajtohet me konstatimet e fakteve nga gjykata në lidhje me rastin e tij dhe me shumën e caktuar për kompensim për dëmet materiale dhe jo-materiale.
19. Faktikisht, parashtruesi nuk e ka mbështetur padinë në baza kushtetuese dhe nuk ka paraqitur prova se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ai autoritet publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
20. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar se si dhe pse Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
21. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së Punës.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të rregullit 36(1.c) dhe 56(2) të Rregullores së punës më 21 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani